

VENDIM
Nr. 610, datë 29.7.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR
AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSHI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2020, i shtohet fondi prej:

a) 370 000 000 (treqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, në zërin “shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit buxhetor 01140 “*e-Queverisja*”, për projektet e investimeve në sistemet IT.

b) 630 000 000 (gjashtëqind e tridhjetë milionë) lekësh, në zërin “shpenzime operative & mirëmbajtje”, të programit buxhetor 01140 “*e-Queverisja*”, për kontratat në vazhdim të mirëmbajtjes së sistemeve IT.

2. Efekti financiar, prej 1 000 000 000 (një miliard) lekësh, përballohet në masën:

a) 140 000 000 (njëqind e dyzet milionë) lekë, nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zërin “shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit buxhetor 04520 “Transporti rrugor”.

b) 860 000 000 (tetëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe